

**VENDIM**  
**Nr. 679, datë 28.9.2016**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2016 PËR  
MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 147/ 2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve, në grupin shpenzime kapitale, si më poshtë vijon:

a) Programit buxhetor 09450, “Arsimi i lartë”, t’i zbritet fondi prej 88 000 000 (tetëdhjetë e tetë milionë) lekësh;

b) Programit buxhetor 09120, “Arsimi bazë”, t’i shtohet fondi prej 88 000 000 (tetëdhjetë e tetë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Niko Peleshi**